

REGIONAL CONFERENCE

# Strengthening Corporate Governance in Albania and Kosovo: Sustainability Reporting and Increased Role of the Audit Committees

10 November 2022, Tirana, Albania

# CFRR»»

**Centre for Financial  
Reporting Reform**

---



**WORLD BANK GROUP**

Centre for Financial Reporting Reform (CFRR),  
Governance Global Practice,  
Europe and Central Asia Region, The World Bank  
Address: Praterstrasse 31, 1020 Vienna, Austria  
Web: [www.worldbank.org/cfrr](http://www.worldbank.org/cfrr)  
Email: [cfrr@worldbank.org](mailto:cfrr@worldbank.org)  
Phone: +43-1-217-0700

## KONFERENCA RAJONALE

# Forcimi i Qeverisjes së Korporatave në Shqipëri dhe Kosovë: Raportimi i Qëndrueshmërisë dhe Rritja e Rolit të Komiteteve të Auditimit

10 Nëntor, 2022, Tiranë, Shqipëri  
Maritim Hotel Plaza Tirana (Rruga Abdi Toptani 18)

### PARATHËNIE

**Programi Rruga drejt Evropës për Reformën e Kontabilitetit dhe Forcimin e Institucioneve për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme ([REPARIS për NVM-të](#))** synon të mbështesë: (i) përmirësimin e mëtejshëm të aksesit të NVM-ve në Ballkanin Perëndimor në shërbimet profesionale të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar, dhe (ii) përafrimin e kornizave të raportimit financiar të korporatave në Ballkanin Perëndimor me direktivat dhe rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian (BE).

Përfitues të këtij programi janë vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

REPARIS për NVM-të bazohet në progresin e arritur në kuadër të Programit të përfunduar BE-REPARIS (2015-2019). Ai ofrohet nga **Qendra** e Bankës Botërore **për Reformën e Raportimit Financiar ([CFRR](#))** me seli në Vjenë, Austri në bashkëpunim të ngushtë me Zyrat e Bankës Botërore në vendet përfituese. Programi përmban trajnime, aktivitete mësimore, asistencë teknike për nëpunësit e sektorit publik, rregullatorët, kontabilistët, audituesit, organizatat profesionale të kontabilitetit, organizatat mbështetëse të biznesit dhe dhomat e tregtisë. Komponentët kryesorë të programit janë:

- (A) Mbështetja për zhvillimin dhe zbatimin e programeve të edukimit dhe trajnimit të qëndrueshëm.
- (B) Mbështetja për transpozimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor kombëtar dhe praktikave të raportimit financiar dhe auditimit me kërkesat e BE-së.
- (C) Mbështetja për një qasje rajonale në zbatimin e reformave të përfunduara të kontabilitetit dhe auditimit.
- (D) Vlerësime të ndikimit mjedisor në peisazh të shërbimeve këshillimore të kontabilitetit dhe Raporteve të Kontabilitetit dhe Auditimit mbi Respektimin e Standardeve dhe Kodeve (A&A ROSC).
- (E) Zbatimi i planit të komunikimit.

Nën komponentin (B), programi bën bashkë anëtarët e Bordit dhe audituesit e jashtëm për të diskutuar dhe identifikuar zgjidhjet e mundshme të sfidave të ndeshura në përmirësimin e raportimit financiar. Këto përfshijnë, për shembull, futjen e kërkesave të qeverisjes nga *acquis* e BE-së dhe qeverisjen financiare të njësive ekonomike me interes publik (NJEIP-të).

Kjo konferencë ka në fokus të saj zbatimin e mëtejshëm të masave të raportimit të qëndrueshmërisë së korporatave që përfshijnë raportimin social dhe mjedisor, rritjen e rolit të komiteteve të auditimit, nxitjen e diskutimeve dhe shkëmbimin e praktikave të mira mbi këto tema. Ajo synon të ndajë njohuritë, përvojën me profesionistë të kësaj fushe dhe palë të tjera të interesuara nga Shqipëria dhe Kosova, si dhe të ofrojë njohuri praktike nga perspektiva lokale dhe ndërkombëtare.

Konferenca zhvillohet pas arritjes së marrëveshjes së Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian mbi Direktivën e Raportimit të Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSRD). Nëpërmjet saj synohet që bizneset të raportojnë informacion të besueshëm, të krahasueshëm dhe të verifikueshëm për përgjegjshmërinë me qëllim riorientimin e investimeve drejt teknologjive dhe kompanive më të qëndrueshme. Kjo Direktivë e rëndësishme do të ndikojë ndjeshëm në ato aktivitete të profesionit që lidhen me raportimin dhe sigurimin e qëndrueshmërisë dhe kualifikimin profesional. Nëpërmjet zgjerimit të fushëveprimit të qëndrueshmërisë, CSRD vendos detyrimin për të gjitha kompanitë e mëdha dhe të listuara të BE-së (me mundësinë e përjashtimit deri në vitin 2028 të NMV-ve të listuara) që të përdorin standarde të detyrueshme të raportimit të qëndrueshmërisë. Njësitë ekonomike do të duhet të raportojnë në përputhje me Standardet e reja Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (ESRS)<sup>1</sup> të hartuara nga Grupi Këshillues Evropian i Raportimit Financiar (EFRAG) me kërkesë të Komisionit Evropian (KE). Sigurimi i jashtëm i cilësisë së raportimit të informacionit të qëndrueshmërisë do të jetë i detyrueshëm. Në lidhje me kompanitë jo-Evropiane, kërkesa për të paraqitur raportin e qëndrueshmërisë do të zbatohet për të gjitha kompanitë që gjenerojnë një qarkullim monetar neto prej 150 milionë euro në BE dhe që kanë të paktën një filial ose degë në BE.

Zbatimi i rregullores do të kryhet në 4 faza:

- viti financiar 2024 (raportet e para publikohen në vitin 2025) për kompanitë që janë tashmë të përfshira në fushëveprimin e direktivës së raportimit jo-financiar
- viti financiar 2025 (raportet publikohen në vitin 2026) për kompanitë që nuk janë tashmë të përfshira në fushëveprimin e direktivës së raportimit jo-financiar
- viti financiar 2026 për NVM-të e listuara (raportet publikohen në vitin 2027), institucionet e vogla dhe jo komplekse të kreditit dhe ndërmarrjet e krijuara për qëllime vetë-sigurimi dhe

---

<sup>1</sup> <https://www.efrag.org/Activities/2105191406363055/Sustainability-reporting-standards-interim-draft>

- viti financiar 2028 (raportet publikohen në vitin 2029) për kompanitë jo-Evropiane me degë/filiale në BE.

Duke pasur parasysh ndryshimin thelbësor rregullator që sjell CSRD, është e rëndësishme që profesionistët dhe kompanitë të fillojnë të përgatiten sa më shpejt të jetë e mundur për zbatimin e saj. Konferenca synon të rrisë ndërgjegjësimin për CSRD dhe ESRS dhe të shqyrtojë veprimet e nevojshme në vendet përfituese të REPARIS për NVM-të.

Në konferencë do të diskutohet gjithashtu mbi reformën e fundit të BE-së për auditimin, e parashikuar nga Direktiva 2006/43/BE<sup>2</sup> dhe Rregullorja 537/2014<sup>3</sup>, e cila ka rritur ndjeshëm rolin e komitetit të auditimit. Tashmë, komiteti i auditimit luan rol vendimtar në forcimin e besimit tek auditimi ligjor dhe informacioni financiar në tërësi. Në përgjithësi, komiteti i auditimit pritet të kthehet në një faktor kyç brenda kornizës së qeverisjes së korporatës, duke përfshirë raportimin financiar dhe raportimin e qëndrueshmërisë të Vendeve Anëtare të BE-së. Është e rëndësishme që vendet të punojnë për funksionimin e qëndrueshëm të praktikave të komitetit të auditimit në të gjithë Evropën. Në konferencë do të paraqiten praktikat e mira ekzistuese të cilat mund të merren në konsideratë nga rregullatorët, profesionistët dhe njësitë ekonomike në Shqipëri dhe Kosovë.

Gjuha e konferencës është anglishtja me përkthim simultan në gjuhën shqipe.

---

<sup>2</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1591342026115&uri=CELEX:02006L0043-20140616>

<sup>3</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32014R0537>

# RENDI I DITËS | E ENJTE, 10 NËNTOR, 2022 | 08:30 - 18:00

**08:30** Regjistrimi dhe Kafja e Mirëseardhjes

---

## Fjala e Mirëseardhjes

---

**09:00**

**Emanuel Salinas** | Menaxher i Bankës Botërore për Shqipërinë, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

**Vasilika Vjero** | Zv. Ministre, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri

**Sokol Shasivari** | Kryetari në detyrë, Këshilli për Raportim Financiar, Kosovë

## Tema Kryesore #1: Kërkesat dhe Standardet e Reja Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë

---

**09:15**

Bordi i Raportimit të Qëndrueshmërisë të EFRAG dhe Grupi i Ekspertëve Teknik të EFRAG për Raportimin e Qëndrueshmërisë kanë hartuar grupin e parë të standardeve ESRS. Ato do t'i paraqiten KE-së në nëntor 2022 për miratim. Prezantimi do t'ju ofrojë pjesëmarrësve një panoramë të përgjithshme rreth përmbajtjes së standardeve si dhe një përshkrim të dispozitave kryesore të CSRD-së.

Prezantimi do të pasohet nga një sesion me pyetje dhe përgjigje.

**Saskia Slomp** | CEO, Grupi Evropian i Raportimit Financiar dhe Këshillimor [via video]

Moderator: **Andrei Busuioc** | Specialist i Lartë për Menaxhimin Financiar, Banka Botërore

**10:45** Pushim Kafeje

---

## Paneli i Diskutimit #1: Raportimi i Qëndrueshmërisë së Korporatës - Ndikimi i Mundshëm dhe Sfidat e Lidhura për Shqipërinë dhe Kosovën

---

**11:15**

Investitorët ndërkombëtarë me portofol ndërkombëtar investimesh po kërkojnë gjithnjë e më shumë raportim cilësor, transparent, të besueshëm dhe të krahasueshëm nga ana e kompanive në lidhje me klimën dhe çështje të tjera mjedisore, sociale dhe të qeverisjes. Paneli do të diskutojë dhe debatojë rreth

ndikimit të mundshëm dhe sfidat e lidhura me të për Shqipërinë dhe Kosovën në kontekstin e miratimit të standardeve ESRS.

Pjesëtarë të Panelit:

**Erisa Rodhani** | Përgjegjës Sektori, Drejtorja e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar, Kontrollin dhe Kontabilitetin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë

**Sadik Berisha** | Anëtar i Këshillit për Raportim Financiar, Kosovë

**Dritan Nako** | Menaxher Ligjor dhe i Marrëdhënieve me Jashtë, ANTEA Cement, Shqipëri

**Teuta Ukshini** | Drejtoreshë e Kontrollit, Kontabilitetit dhe Raportimit në Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike

**Kledi Kodra** | Partner Menaxhues, Grant Thornton, Shqipëri

**Arta Limani** | Drejtoreshë në Departamentin e Auditimit & Sigurisë, Deloitte Kosovë

Moderatorë:

**Jonida Myftiu** | Specialiste e Lartë për Menaxhimin Financiar, Banka Botërore

**Andrei Busuioc** | Specialist i Lartë për Menaxhimin Financiar, Banka Botërore

12:30 **Drekë**

## Tema Kryesore #2: Çfarë e Bën Efektiv një Komitet Auditimi?

Komiteti i auditimit është një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e palëve që sigurojnë raportimin e duhur dhe sigurinë përkatëse të ofruar nga audituesit. Rregullimet e komitetit të auditimit duhet të jenë proporcionale me detyrën dhe mund të ndryshojnë sipas madhësisë, kompleksitetit dhe profilit të rrezikut të njësisë ekonomike. Prezantimi do të diskutojë mbi rolin dhe përgjegjësitë e komitetit të auditimit në lidhje me raportimin financiar dhe të qëndrueshmërisë dhe do të ofrojë njohuri mbi përballimin e sfidave të implementimit të një komiteti efektiv auditimi sipas dispozitave të *acquis* të BE-së.

Prezantimi do të pasohet nga një sesion me pyetje dhe përgjigje.

**Peter van Veen** | Drejtor i Qeverisjes & Administrimit të Korporatës, Instituti i Kontabilistëve të Miratuar në Angli dhe Uells

Moderator: **Andrei Busuioc** | Specialist i Lartë për Menaxhimin Financiar, Banka Botërore

13:30

**Roli Kyç i Komiteteve të Auditimit për Transparencën dhe Llogaridhënien – Përvijë Praktike nga Sllovenia**

14:30

Ky sesion do të ofrojë një shembull të mirë praktik bazuar në aktivitetet e komiteteve të auditimit në Slloveni, duke nxjerrë në pah edhe çështje të rëndësishme për sektorin bankar.

Prezantimi do të pasohet nga një sesion me pyetje dhe përgjigje.

**Blanka Vezjak** | Anëtare e Jashtme e Komiteteve të Auditimit, Slloveni

Moderatore: **Svetlana Platon** | Konsulente, Banka Botërore

## 15:00 Pushim Kafeje

### Paneli i Diskutimit #2: Përmirësimi i Efektivitetit të Komitetit të Auditimit në Shqipëri dhe Kosovë duke marrë parasysh statusin aktual dhe praktikën e mirë ndërkombëtare

Në këtë sesion, pjesëtarët e panelit, ku bëjnë pjesë edhe anëtarë të komitetit të auditimit të kompanive me bazë ose aktivitete të rëndësishme në Shqipëri dhe Kosovë, do të diskutojnë mbi komitetet e auditimit dhe do të sugjerojnë fushat të cilat kanë potencialin më të lartë për përmirësimin e efektivitetit të aktivitetit të anëtarëve të komitetit të auditimit në promovimin e raportimit transparent dhe cilësor të qëndrueshmërisë të korporatës dhe auditimit.

15:30

Pjesëtarë të Panelit:

**Teuta Baleta** | Kryetare e Komitetit të Auditimit, Union Bank e Shqipërisë

**Mentor Hyseni** | Kryetar i Komitetit të Auditimit në AKP, Agjencia Kosovare e Privatizimit

**Amir Dermal** | Auditues, BDO Global, Kosovë

**Elvis Ziu** | Udhëheqës Këshillues, PWC, Shqipëri

**Dritan Fino** | Kryetar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Shqipëri

**Faton Ahmetaj** | Anëtar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Kosovë

Moderatore: **Laura Qorlazja** | Përfaqësuese për Shqipërinë, Korporata Financiare Ndërkombëtare, Grupi i Bankës Botërore

### Shqipëri - Projekti për Forcimin e Cilësisë së Auditimit dhe Raportimit

Në këtë sesion do të prezantohen aktivitetet kryesore që janë planifikuar për t'u realizuar në Shqipëri si pjesë e Projektit për Forcimin e Cilësisë së Auditimit dhe Raportimit, financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

16:45

Drejtuues sesioni:



**Dritan Fino** | Drejtor, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri  
Moderator: **Andrei Busuioc** | Specialist i Lartë për Menaxhimin Financiar, Banka Botërore

**17:15** Mbyllja e Konferencës

**17:30** Darkë

